

## **PROCES-VERBAL**

Dëgjesë Publike: Njësia Administrative Klos

Datë 30.10.2020, ora 13.00

Marrin pjesë Kryetari i Bashkisë, Nënkyetari i Bashkisë, Nënkyetarja e Bashkisë, Përgjegjësja e Sektorit të Financës, Administratori i Njesisë Administrative Klos, Përgjegjësja e Zyrës së Planifikimit dhe Ndjekjes së Investimeve.

Hap mbledhjen Kryetari i Bashkisë Z. Ilmi Hoxha

Falenderon pjesëmarrësit dhe prezanton stafin që e shoqëron. Qëllimi i takimit është për të diskutuar rreth projekt-buxhetit dhe paketës fiskale të vitit 2021. Paketa fiskale mund të ketë nevojë për ndryshime. Fatkeqësisht jemi një nga Bashkitë që jemi prekur nga tërmeti. Kemi harxhuar kohë dhe burime njerëzore gjatë kësaj kohe. Gjithashtu kemi harxhuar kohë për masat që janë marrë në lidhje me pandeminë. Deri me date 23.06.2020 ka qene e bllokuar puna me thesarin për shkak të pandemisë. Falë bashkëpunimit me Kryetarët e fshatrave kemi zgjidhur problem në lidhje me ujin vaditës dhe me ujin e pijshëm. Sot jemi për të marrë kërkesat tuaja kryesore që ti projektojmë për vitin 2021 dhe ti realizojmë ato.

Merr fjalën Përgjegjësja e Sektorit të Financës Znj. Silvana Bala:

Paraqet në mënyre të shkurtuar buxhetin e vitit 2020 në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara dhe paraqet transfertat e pakushtëzuara, sektoriale, të kushtëzuara dhe të ardhurat e planifikuara për vitin 2021.

Merr fjalën Z. Avni Keta, Kryetar i Fshatit Bejnë:

Kërkon informacion në lidhje me buxhetin që do alokohet për secilin nga fshatrat:

Merr fjalën Kryetari:

Shpjegon sesi do të ndahet tranferta e pakushtëzuar.

Analizon arsyet që kanë ndikuar në mbledhjen e ulët të taksave, ku përmend: tërmetin, pandeminë, mbylljen e minierave.

Në lidhje me buxhetin e Bashkisë një pjesë të konsiderueshme e marrin pagat për punonjësit.

Një pjesë duhet lënë për detyrimet e prapambetura. Mundësi e mire janë të ardhurat që merr Bashkia nga Bashkimi Evropian për investime të ndryshme.

Flet Asllan Mëziri (F.Klos-Katund)

Tregon shqetësimin në lidhje me aksin që shkon për Shëngjun i cili ka nevojë për cakull.

Flet Petriti (Klos-Katund)

Shpreh shqetësimin për shtëpinë e Faik Allushit sepse po rrezikohet rruga, e cila ka nevojë për tombina dhe mure.

Merr fjalën Idriz Kola (Q.Klos)

Shpreh shqetësimin duke sqaruar që një pjesë e banorëve të Klosit janë në tokat e shtetit.

Tokat e shtetit mund të shiten dhe tu kalojnë në pronësi banorëve. Flet për përmirësimet që janë bërë në pastrim, polici, ujësjellës.

Flet Astrit Muça (Bërshi)

Flet në lidhje me njoftimet që janë bërë në lidhje me taksat që kanë banorët ndaj bashkisë.

Gjithashtu shprehet për nevojën që ka fshati i tij për rrugë.

Merr fjalën Shkëlzen Sinani (Cerujë)

Tregon që Ceruja është një burim të ardhurash për shtetin duke qenë se ka minierat.

Shpreh shqetësimin për investimet e pakta që ka pasur në rrugë, ujë dhe në shkollë.

Flet Hysni Bala (Pleshë)

Flet për shqetësimet e banorëve të fshatit të tij në lidhje me ujë dhe pijshëm, ujë vaditës dhe rrugën e varrezave (Lagjia Lika).

Kryetari merr fjalën dhe thotë që duhet të jemi bashkëpunues që punët të shkojnë ashtu siç duhet.

Gjithashtu flet edhe për varrezat që duhen rrethuar.

Merr fjalën Afrim Krosi (F.Bel)

Ashtu si dhe në fshatrat e tjerë edhe në Bel ka shqetësime në lidhje me rrugën, ujin e pijshëm dhe kanalin vaditës.

Bajram Mjeshtri (Dars)

Flet për shqetësimet e banorëve të fshatit të tij në lidhje me ujin e pijshëm, ujin vaditës dhe në lidhje me rrugët.

Problem kryesor mbetet edhe cështja e mbeturinave.

Haki Çira (F.Fullqet)

Në Fullqet problem kryesor është vaditja. Sifoni që është nxjerrë poshtë te ura e Fullqetit u shërben vetëm 6 famileve. Pjesa tjetër ka nevojë për tu hap kanali te rruga te lagjia Dushk. Problem është dhe uji i pijshëm.

Flet Avni Keta i cili për qytetin e Klosit shpreh shqetësime në lidhje me tregun, zgjerimin e Urës së Allamanit dhe vendin për pazarin e gjësë së gjallë.

Para mbylljes së takimit Kryetari pyet të pranishmit nëse janë dakort qe ta mbajmë sportin. Ai thotë që të ngresh sportin është vlerë, por problem qëndron se Bashkia Klos nuk ka as fushë as trajnerë dhe pak futbollistë.

Por të pranishmit shprehën dëshirën qe sporti të mbahet si një vlerë e shtuar për Klosin.

Kryetari mbyll takimin duke falenderuar pjesëmarrësit për ato cka paraqitën në takim dhe kërkon bashkëpunim.

Përgjegjëse e Sektorit të Financës

Silvana Bala

